



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

247  
Nr. .... prot.

Tiranë, më 23.02.2024

Vendim

Nr. 21 datë 23.02.2024

**Për miratimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2023, programin dhe prioritet e veprimtarisë të saj për vitin 2024, disa shtesa dhe ndryshime në Statut dhe miratimin për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin *akademik***

Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 23 shkurt 2024, zhvilluar sipas rendit të ditës (bashkëngjitur), me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të institucioneve sipas nenit 29, pika 2 e 3 të Statutit të ASH;

Pas verifikimit të të pranishmëve fizikisht dhe *on-line*, si dhe të plotësimit të *kuorum*-it sipas parashikimit në Statut (bashkëngjitur);

Pas dëgjimit të raportit për vitin 2023 si dhe programin e prioritet për vitin 2024 të ASH e të njëjstive të përhershme, paraqitur nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave (bashkëlidhur) e diskutimeve për to;

Në mbështetje të vendimit të Kryesisë nr. 12, datë 23.01.2024 *Për disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e ASH* (bashkëlidhur);

Në mbështetje të vendimit të Kryesisë nr. 11, datë 23.01.2024 *Për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin "akademik"* (bashkëlidhur);

Me votim të hapur Asambleja,

Vendosi:

1. Të miratojë raportin për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave për vitin 2023 (bashkëlidhur);
2. Të miratojë në parim shpërndarjen e buxhetit për Akademinë e Shkencave dhe njësitë e përhershme të kërkim-studimit të albanologjisë, për vitin 2024 (bashkëlidhur);
3. Të miratojë projektet shkencore për vitin 2024 (bashkëlidhur);
4. Të miratojë në parim veprimtaritë shkencore të parashikuara për vitin 2024 (bashkëlidhur);
5. Të miratojë në parim veprimtarinë botuese të Akademisë së Shkencave (bashkëlidhur);
6. Të miratojë propozimet për plotësimin e ndryshimeve të Statutit sipas vendimit 12, datë 23.1.2024 të Kryesisë *Për disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e ASH* (Statuti bashkëlidhur);
7. Të miratojë vendimin e Kryesisë nr. 11, datë 23.01.2024 *Për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin "akademik"*;
8. Për miratimin e këtij vendimi ngarkohen: Kryesia e ASH, sekretari shkencor i ASH, kryetarët e seksioneve, kryetarët e komisioneve të përhershme të ASH, drejtuesit e njësive të përhershme të kërkim-studimit të albanologjisë, drejtuesit e njësive të përkohshme të kërkim studimit dhe kancelari.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

